

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje artikuj ushqimor”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

“Blerje mish vici, vezë, bulmet, qumësht, djathë, patate,vaj ulliri,vaj luledielli,djath i fresket,miell” – 15111200-1, 15112130-6, 03142500-3, 15511000-3, 15542000-9, 15542100-0,15310000-4,15411110-6,15411200-4,15542000-9,15612100-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

- 1. Fondi limit : 18.333.250 (tete mbedhjetë milion e tre qind e tri dhjetë e tre mijë e dy qind e pesë dhjetë)leke pa t.v.sh ,i ndare si më poshtë:**
 - Fondi limit për çerdhet është : 5.833.325 (pesë milion e tete qind e tri dhjetë e tre mijë e tre qind e njetë e pesë) leke pa t.v.sh.**
 - Fondi limit për kopshtet është 12.499.925 (dy mbedhjetë milion e katër qind e nente dhjetë e nente mijë e nente qind e njetë e pesë) leke pa t.v.sh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2 dhe pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 , ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqeruara me akt-ekspertizë të ekspertit kontabel, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave).

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara,
- Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të

thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2. Operatori ekonomik pjesmarres duhet të disponojë Certificate ISO 9001-2015 **”Per menaxhimin e cilesise”**objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit,te vlefshme , ISO 22000: 2018 **sistemin e Menaxhimit te Sigurise Ushqimore”**objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit te vlefshme ose ekuivalente me to, Certificate ISO 14001-2015 **”Per sistemin e Menaxhimit te Mjediset”**objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit,te vlefshme, Çertifikate **ISO BS OHSAS 18001 :2007 ”Per sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Pune”**

Në rastin e BOE certifikatat duhet të paraqiten nga secili prej anëtareve të BOE.

Argumentimi: *Paisja me këto certifikata ISO, garanton që OE konkurues plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve ushqimore që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm si dhe plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore.*

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon të paktën 5 punonjës duhet të paraqesë listë pagesen e deklaruar përmes formës elektronike për muajin janar-shkurt 2023 , si dhe të paraqesë librezat shëndetësore për 5 punonjësit.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës, me qëllim përmbushjen e nevojave për furnizimin e vazhdueshëm, të përditshëm e të pandërprër të Drejtorisë Cerdhe dhe kopshte me artikujt objekt prokurim. Në funksion të sa më sipër minimalisht nevojiten: 2 shoferë, 1 furnitor, 1 magazinier dhe 1 ekonomist.*

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon dy mjete transporti ku njeri prej tyre është ATV frigoriferik, ne pronësi ose ne përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës marrëveshje kuadër.

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon mjetin e transportit ATV frigoriferik, ne pronësi ose ne përdorim sipas kontratës noteriale, të vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie.
- akt kolaudimi,
- policen e sigurimit të mjetit
- taksen vjetore
- lejen e transportit nga komuna apo bashkia për vete ose të tjerë.

Argumentimi: Arsyeja përse është kërkuar automjeti ATV është bërë duke marrë parasysh kushtet në të cilat duhet të kryhet transporti i produkteve të këtyre llojeve. Duke iu referuar Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, për transportin e këtyre produkteve kërkohen kushte frigoriferike, për rrjedhojë, automjetet kërkohet të jenë frigoriferikë, d.m.th ATV.

2.3.5. Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licence me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të prokurimit:

- Për OE/BOE vendas:
Licença të jetë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme:
Kategoria: II.1 .A Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.
Kategoria II.1.B”Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtetërore”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo është Licença bazë për Prodhimin/tregëtimin e ushqimeve për njerëz, referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB.

2.3.6. Operatoret ekonomik duhet të kenë në pronësi për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës objektin njësi tregtare mishi e përshtatshme për tregëtimin e mishit dhe nënprodukteve të tij objekt prokurimi e pajisur me Leje Higjienosanitare me dhomë frigoriferike ose nëse është

me qera duhet te paraqesin kontraten e qirase e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates dhe te figuroje i rregjistruar ne QKB si aktivitet.

2.3.7 . Operatori ekonomik pjesmarres duhet te kene ne pronesi ose me qera stalle per mbashtrimin e bagetive e paisur me liçense nga QKB ose kontrate furnizimi per produktet objekt prokurimi e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates e shoqeruar me liçensen leshuar nga QKB te furnizuesit.

Për OE/BOE vendas:

- Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e më poshtme:
- Kategoria : II.3 Rritja ose tregtimi i kafshëve.
- Nënkatëgoria: II.3.A Mbarështimi i kafshëve në fermat agrolektorale të mëdha.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB.

Siç është parashikuar dhe në specifikimet teknike, hartimi i të cilave i është referuar “STASH 1441/87”, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre”, mishi duhet të jetë i cilësisë së parë, i freskët, dhe furnizmi me mish të freskët të bëhet jo më parë se 6 orë nga koha e therjes në verë, ndërsa në dimër 12 orë dhe do të shoqërohet me Raport Veterinar.

Autoriteti kontraktor e bën porosinë për mish viçi tek furnitori, çdo ditë, pasi ka llogaritur nevojat ditore.

Për përmbushjen e këtyre kërkesave, kontraktori duhet të vërtetojë se i ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet për t’iu përgjigjur kërkesave të Autoritetit Kontraktor, çdo ditë për sasinë dhe parametrat e kërkuar.

2.3.8 Operatoret ekonomik duhet te jene te pajisur me liçense leshuar nga QKB per prodhimin e bukes ose kontrate furnizimi per produktin objekt prokurimi e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates e shoqeruar me liçensen leshuar nga QKB te furnizuesit.

2.3.9 Operatoret ekonomik duhet te kene ne pronesi per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates objektin njesi tregtare ushqimore e pajisur me Leje Higjenosanitare ose nese eshte me qera duhet te paraqesin kontraten e qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates dhe te figuroje i rregjistruar ne QKB si aktivitet .

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB.

Për OE/BOE

Operatori ekonomik në vetdeklarimin e paraqitur për plotësimin e këtij kriteri duhet të përshkruaj qartësisht:

- Për licencën:
 - institucionin që ka lëshuar licencën përkatëse dhe website-in zyrtar të institucionit;
 - veprimtarinë përshkruese për të cilën është licencuar;
 - datën e lëshimit të licencës;
 - statusin e saj aktiv
- Për lejen higjeno-sanitare:
 - institucionin që ka lëshuar lejen higjeno-sanitare dhe website-in zyrtar të institucionit;
 - datën e lëshimit të saj;

2.3.10 Operatores ekonomik duhet te kene ne pronesi per te gjithë periudhën e zbatimit të kontratës objektin njësi tregtare ushqimore e pershtatshme per tregimin e bylmetrave objekt i prokurimit e pajisur me Leje Higjenosanitare ose nese eshte me qera duhet te paraqesin kontratën e qerave e vlefshme per te gjithë periudhën e zbatimit të kontratës dhe te figuroje i rregjistruar ne QKB si aktivitet.

Argumentim: Për përcaktimin e këtij kriteri, Komisioni ka marrë parasysh natyrën delikate të furnizimit me këto produkte të cilat do konsumohen nga fëmijë të moshave nga 6 muaj deri në 6 vjeç.

Gjithashtu sasia e konsiderueshme e planifikuar në zbatim të menusë për artikuajt qumësht djath, djath , kërkon që OE të sigurojë garanci për furnizim në zbatim të kontratës.

Këtë kriter e përcakton edhe fakti i kërkesës për gjurmueshmërinë e produkteve të këtij prokurimi, në zbatim të VKM Nr. 760, datë 16.9.2015”Për kërkesat e për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor”

Për më tepër, nga Komisioni, është kërkuar që “Njesia e Prodhimit të Bulmetit” duhet të jetë në pronesi ose në përdorim sipas kontratës noteriale. Pra çdo OE mund të paraqesë një kontratë noteriale bashkëpunimi me një “Njesi Prodhimi Bulmeti” me kapacitetet e kërkuara për të garantuar vazhdimësinë e zbatimit të kontratës.

2.3.11 Operatores ekonomik pjesmarres duhet te kene kontrate furnizimi per produktet objekt prokurimi(bulmetra)e vlefshme per te gjithë periudhën e zbatimit të kontratës e shoqeruar me liçensen leshuar nga QKB te furnizuesit dhe leje higjeno –sanitare.

2.3.12 Raport-Analiza te produktit qe prokurohet per vitin 2023 ku te perfshihen te gjithë treguesit e percaktuar ne specifikimet teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo është Licenca bazë për Prodhimin/tregëtimin e ushqimeve për njerëz, referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB.

2.3.13.Operatoret ekonomik duhet te paraqesin nje çertifikate qe verteton se subjekti eshte inspektuar nga ana e AKU viti 2022.

Argumentim: Kjo kërkesë i referohet shkresës të APP nr. 10181 prot, datë 19.11.2018, “Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.

2.3.14.Operatoret ekonomik duhet te kete per gjashte muajt e fundit nje specialist veterinar dhe specialist teknolog te vertetuar kjo me kontrate te rregullt pune.cv.diplome listpagesat per periudhen e mesiperme.

2.3.15Per arsye se furnizimi do te jete ditor dhe ne ore te percaktuar sipas grafikut bashkengjitur DTS kerkohet qe operatoret ekonomik pjesmarres ne tenderin e mesiperm duhet te ushtrojne aktivitetin e tyre ne qytetin ku ndodhen institucionet e varesise ose te kene pike kontakti ne qytet si adrese te dyte,te vertetuar me dokumentacion perkates ligjor, i rregjistruar ne QKB e ofertuesit si adrese e dyte ushtrimi aktiviteti si dhe te jete i pajisur me leje higjeno-sanitare..

Argumentim: Kjo kërkesë është vendosurduke iu referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB.

Këtë kriter e përcakton edhe fakti i kërkesës për gjurmueshmërinë e produkteve të ketij prokurimi, në zbatim të VKM Nr. 760, datë 16.9.2015”Për kërkesat e për gjurmimin e ushqimit përgjatë zinxhirit ushqimor”

Meqenese furnizimi eshte cdo dite nga e hene-premte dhe fillon nga ora 07.00-09.00 per siguruar efikasitet,cilesi dhe freski te mallit ne baze te nevojave ditore.

2.3.16 Operatori ekonomik duhet te paraqesë nje moster për çdo artikull të kërkuar sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor.

Mostrat e kërkuara do paraqiten ne daten dhe oren e hapjes se ofertave, prane Drejtorise Cerdheve dhe Kopshteve ,Shkoder ,adresa :L.Perash,Rr.Skenderbeg.

Mostrat e kerkuara duhet te kene nje etikete e cila te permbaje elementet: moster “emri i artikullit”, daten e zhvillimit te tenderit, emrin e ofertuesit, nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik.

Ditën e paraqitjes së mostrave, operatori ekonomik duhet te paraqese per secilin nga artikujt e lotit së bashku me mostrat edhe dëshmi te rezultateve te testimeve zyrtare, origjinale ose kopje të noterizuar (te leshuara nga institucione te autorizuar dhe të akredituara të kontrollit ose referencës, qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike).

Mungesa e mostres eshte kusht skualifikues.

Argumentim: Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 40, pika 6/a. Si dhe per arsye të rritjes së sigurisë në procesin e administrimit dhe ruajtjes së mostrave.

2.3.13 Oferta, dëshmitë e rezultateve te testimeve zyrtare, ankesat, në të gjitha fazat e procedurës prokurimit, kërkesat për sqarim dhe çdo dokumentacion tjetër i kërkuar në DST duhet të jetë në gjuhën shqipe.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

- Per hartimin e specigikimeve teknike jane referuar:
- Standardeve Shtetërore në fuqi STASH, për çdo artikull.
- Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.
- VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit”.
- Udhezimin nr. 5, datë 25.03.2011 “Për kërkesat specifike të higjenës për stabilimentet e prodhimit, grumbulimit dhe përpunimit të produkteve me bazë qumshti”,
- Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit dhe të produkteve me bazë qumshti”.
- Urdher i Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së Konsumatorit nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”.
- Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016 “ Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

- Ligjin nr. 9308 datë 04.11.2004, “Mbi shërbimin dhe inspektoriatin veterinar”, për normat e tregëtimit të zbatueshëm për vezët.
- Rregulloren nr. 1 datë 25.05.2002 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.
- Udhëzimin nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645 datë 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014 Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.
- Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre”.
- Udhëzimin nr. 207, datë 31.03.2015 i Ministrit të Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Admnistrimit të Ujrave “Për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të parapaketuar, për t’u shitur te konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore”, Shtojca 3.
- Udhëzimin nr. 15, datë 09.09.2021 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “për Kriteret Mikrobiologjike për produktet ushqimore.
- Ligji nr. 9942, datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.